

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e trembëdhjetë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 7.10.2025**

**Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

**Punonjësit nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e trembëdhjetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 20:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e dymbëdhjetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 26.9.2025.
2. Raport nga monitorimi në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës për Zgjedhjet Lokale 2025, nga 10 gushti deri më 28 shtator.
3. Propozim për inicimin e procedurës kundërvajtëse kundër SHTR TV Gurra SHPKNJP Kërçovë për shkelje të nenit 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje e sistemit harduer për monitorim të shërbimeve TV dhe radio dhe mbikëqyrjen e ORRPKE.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: Energji elektrike.
6. Të ndryshme.

## **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin nga seanca e dymbëdhjetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 26.9.2025, me tekstin e propozuar.

## **Pika 2**

Në prezantimin e tij, dr. Trajçevski njoftoi se do të japë një përmbledhje hyrëse të shkurtër, ndërsa informacione më të hollësishme dhe përgjigje për pyetje të mundshme do të prezantojë udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska. Ai theksoi se sipas përfundimeve të gjetjeve kryesore, në periudhën e analizuar nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor nga ana e radiodifuzerëve të përfshirë në monitorimin e Agjencisë. Shërbimi publik i përmbushi detyrimet e tij ligjore, ndërsa stacionet televizive komerciale TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel, TV Telma, TV 21-M dhe TV 24 Vesti në pjesën më të madhe i përmbaheshin parimeve të raportimit objektiv dhe të paanshëm, duke siguruar trajtim të barabartë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme. Në këtë mënyrë, publiku pati mundësinë lirshëm të formojë mendimin e vet për ngjarjet dhe çështjet me interes publik dhe të marrë vendim të informuar se për kë të votojë në zgjedhjet e ardhshme. Si përjashtim, dr. Trajçevski theksoi se TV Alfa nuk e respektoi këtë parim as në mënyrë sasiore dhe as cilësore, ndërsa TV Alsat-M nuk e respektoi në mënyrë të vazhdueshme nga aspekti cilësor. Në këtë periudhë monitorimi, nuk parashikohen sanksione për mosrespektimin e standardeve profesionale gazetareske. Ai shprehu pritjen se me fillimin e fushatës zgjedhore, këto dy media do të përmirësojnë mënyrën e raportimit, që do të thotë se Agjencia nuk do të ketë nevojë të inicon procedura ligjore në përputhje me Kodin Zgjedhor. Drejtori gjithashtu theksoi se për secilin nga nëntë shërbimet programore – shërbimi publik dhe shtatë televizionet komerciale është përgatitur raport i detajuar mbi aspektet cilësore dhe sasiore të raportimit në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës, nga 10 gushti deri më 28 shtator 2025.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, shtroj pyetje teknike drejtuar Udhëheqëses së Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska. Ai u interesua nëse subjektet e listuara në tabelat e Raportit për monitorim të radiodifuzerëve janë renditur sipas rendit alfabetik apo sipas kriteri tjetër, duke vënë në dukje se subjekti politik "Vred" është pozicionuar në fund të listës.

Udhëheqësja mr. Emilija Janevska, shpjegoi se subjektet nuk renditen sipas rendit alfabetik, sepse aplikacioni që shfrytëzon shërbimi për monitorim, "NAVS", është në përdorim për një kohë të gjatë dhe zbatohet në procese të ndryshme zgjedhore. Ajo shpjegoi se subjektet nuk regjistrohen sërish për çdo zgjedhje, por shfrytëzohen të dhënat ekzistuese nga baza, me qëllim që të shmanget ngarkesa e panevojshme në sistem. Prandaj, subjekte të caktuara kanë numra serialë më të ulët (për shembull, 1 ose 2), dhe të tjerë më të lartë (si 396), varësisht nga koha kur janë futur për herë të parë në sistem. Janevska theksoi se këto numra nuk kanë lidhje me numrat e caktuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), por i referohen në veçanti bazës së të dhënave të brendshme të Agjencisë. Ajo shpjegoi më tej se çdo subjekt, kur paraqitet për herë të parë në proces zgjedhor, merr numër unik në sistem. Nëse i njëjti subjekt përsëri merr pjesë me të njëjtin emër, për shembull nga Zgjedhjet Lokale 2021 deri në zgjedhjet aktuale, ruhet i njëjti numër nga baza e të dhënave. Prandaj, renditja e subjekteve në tabela nuk është as sipas rendit alfabetik dhe as sipas renditjes së përcaktuar

nga shorti i KSHZ, por sipas rendit në të cilin ato janë regjistruar në bazën e të dhënave të Agjencisë.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski plotësuese sqaroi se në fillim të monitorimit, më 8 gusht, KSHZ nuk kishte realizuar ende short për renditjen e subjekteve. Prandaj, Agjencia në atë moment nuk ishte në gjendje të ndryshonte orarin e përcaktuar nga KSHZ.

Udhëheqësja e Sektorit programor, mr. Emilija Janevska, shpjegoi se rezultatet e monitorimit tregojnë se në periudhën nga 10 gushti deri më 28 shtator 2025, e cila llogaritet si periudhë parazgjedhore, në emisionet informative të televizioneve të analizuara në nivel shtetëror ka pasur një numër të vogël fragmentesh që lidhen drejtpërdrejtë me Zgjedhjet lokale. Ajo theksoi se shumica e fragmenteve lidhur me zgjedhjet i referohen çështjeve për statusin dhe mundësit zgjedhore të kandidatëve të pavarur, temë që tërhoqi vëmendje të rëndësishme mediatike dhe është përpunuar nga të gjitha mediat e analizuara. Plotësuese, pjesë e raportimeve lidhej me aktivitetet e Komisionit Shtetëror Zgjedhor dhe komisioneve komunale zgjedhore, veçanërisht në lidhje me procesin e kompletimit të listave të kandidatëve. Mediat gjithashtu raportuan për spekulimet e partive në lidhje me koalicionet e mundshme, si dhe për pritshmërit e ekspertëve dhe analistëve politikë në lidhje me formimin e tyre dhe strategjitë e komunikimit në fushatën e ardhshme zgjedhore. Janevska theksoi se raportet që lidhen me Zgjedhjet lokale kryesisht ishin përqendruar në disa nga këto fusha tematike. Megjithatë, mediat treguan interes të veçantë edhe për tema të tjera aktuale gjatë periudhës parazgjedhore. Ndër më të përfaqësuara ishin shtojcat mbi zjarret dhe pasojat e tyre ekonomike, shëndetësore dhe mjedisore. Gjithashtu, është vënë re dhe prania e shtojcave kushtuar integritetit evropian dhe aktiviteteve të Qeverisë, si dhe pasojave të zjarrit në diskoteken "Puls" në Koçani, të cilat shkaktuan interes të rëndësishëm publik. Udhëheqësja vuri në dukje se karakteristikë e periudhës së analizës është që pothuajse të gjitha stacionet televizive i kushtuan kohë të rëndësishme emisioneve informative raportimit mbi aktivitetet e rregullta të Qeverisë. Kjo ishte më e dukshme në TV Alfa dhe TV Sitel, të cilat i kushtuan afërsisht shtatë orë të kohës totale të lajmeve raportimeve të tilla, ku TV Sitel rreth gjysmën e kësaj kohe ka referuar për intervista të realizuara në kuadër të lajmeve. Janevska vuri në dukje, siç u theksua më parë nga drejtori dr. Zoran Trajčevski, mediat në përgjithësi respektuan parimet dhe standardet profesionale gjatë raportimit. Në lidhje me shërbimin publik radiodifuziv – Radiotelevizioni i Maqedonisë (RTM), ajo theksoi se janë përmbushur detyrimet për informim të procesit zgjedhor, por pjesërisht është përmbushur detyrimi për organizim të emisioneve debative. Sipas Kodit Zgjedhor, shërbimi publik ka detyrim që nga dita e shpalljes së zgjedhjeve të organizojë përballje(debate) midis partive më të mëdha politike nga pushteti dhe opozita, dhe nga fillimi i fushatës zgjedhore me pjesëmarrës në procesin zgjedhor. Në periudhën e cekur, RTM organizoi katër emisione debative në Shërbimin e parë programor televiziv dhe dy në Shërbimin e dytë programor televiziv, por të ftuarit në emision ishin analistë politikë, dhe jo përfaqësues të partive politike, që paraqet përmbushje të pjesshme të detyrimit ligjor. Janevska gjithashtu theksoi praktikën e disa televizioneve komerciale për t'i kushtuar vëmendje procesit zgjedhor përmes emisioneve speciale informative, intervistave dhe debateve. Kështu, intervista u transmetuan nga TV Alfa, TV Kanal 5, TV 21-M, TV Sitel dhe TV 24 Vesti, ndërsa emisionet debative u organizuan nga TV 24 Vesti, TV Telma dhe TV 21-M. Në këto emisione ishte karakteristike që të ftuarit ishin kryesisht analistë politikë dhe ekspertë, dhe jo përfaqësues politikë.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, vuri në dukje se në shpjegimin e udhëheqëses Janevska, televizionet komerciale janë të listuara me emrat e tyre zyrtarë,

ndërsa Radiotelevizioni i Maqedonisë përmendet si "shërbim publik". Ai propozoi që në të ardhmen të gjitha mediat të listohen me emrat e tyre zyrtarë, duke theksuar se në Regjistrin Qendror, RTM nuk është regjistruar me emrin "shërbim publik", por me emrin e saj të plotë Radiotelevizioni i Maqedonisë (RTM).

Udhëheqësja mr. Emilija Janevska, shpjegoi se, sipas Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), Radiotelevizioni i Maqedonisë është shërbim publik radiodifuziv, i cili përfshin shërbime programore televizive dhe radio. Prandaj, në raportet e Agjencisë përdorin termin "shërbim publik" si përshkrim normativ, dhe jo si përemër për emrin zyrtar të institucionit.

### **Pika 3**

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi propozimin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër SHTR TV Gurra SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të nenit 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor. Ai informoi se prej ditës së fillimit të fushatës zgjedhore, më 29 shtator, gjatë monitorimit të disa radiodifuzerëve, u konstatua se ishin tejkaluar limitet e lejuar për reklamim politik të paguar (RPP). Nga ku RA Kanal 77 u vërejt tejkalim i kohëzgjatjes së lejuar të reklamimit politik të paguar për VMRO-DPMNE, TV 21-M për koalicionin VLEN, dhe TV Gurra, si dhe ndoshta te disa radiodifuzer të tjerë, gjithashtu u konstatua se kishin tejkaluar kohëzgjatjen e lejuar. Të gjithë radiodifuzerët u kontaktuan në kohën e duhur nga Agjencia dhe u konstatua se shumica e kohës kishte të bënte me gabim teknik. Pas paralajmërimit të Agjencisë, shkeljet nuk u përsëritën në asnjërin prej radiodifuzerëve, përveç TV Gurra. Në këtë radiodifuzer, shkeljet kishin të bënin me reklamim politik të paguar për koalicionin Vlen dhe koalicionin e udhëhequr nga partia politike BDI. Pavarësisht paralajmërimeve fillestare të Agjencisë, TV Gurra vazhdoi të transmetonte spote politike të paguara me kohëzgjatje që tejkalon afatet kohore të përcaktuara me ligj në përputhje me Kodin Zgjedhor. Për shkak të parregullsive të konstatuara, propozohet iniciimi i procedurës kundërvajtëse kundër SHTR TV Gurra SHPKNJP Kërçovë, me ç'rast në Raportin e monitorimit janë cekur të gjitha shkeljet e konstatuara në formë të detajuar.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga shtroj pyetje nëse, pavarësisht se Agjencia ka kontaktuar me TV Gurra dhe ju është sugjeruar gabimi i konstatuar, radiodifuzeri sërish ka vazhduar me të njëjtën shkelje.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi se Sektori për çështje programore ishte në komunikim të drejtpërdrejtë me TV Gurra dhe sugjeroi shkeljen konkrete të limiteve të lejuar për reklamat politike të paguara. Megjithatë, pavarësisht indikacioneve të dhëna, radiodifuzeri vazhdoi ta përsëriste shkeljen. Ai tregoi se, sipas mendimit të tij, disa radiodifuzer lokalë gabimisht supozojnë se Agjencia nuk ka mundësi të monitorojë programin e tyre nga Shkupi. Ai shpjegoi se kjo nuk është e saktë, sepse Agjencia ka sistem të veçantë monitorimi, nëpërmjet të cilit operatorët kabllorë e dërgojnë sinjalin në Shkup, pas së cilës Agjencia e merr dhe monitoron materialin programor me vonesë prej një ore. Dr. Trajčevski shtoi se TV Gurra ka pronar të ri që nga viti i kaluar dhe supozoi se ndoshta për shkak të mosdijes së sistemit të funksionimit të Agjencisë, kanë llogaritur se programi i tyre nuk është i disponueshëm për monitorim nga ASHMA-ja në Shkup. Ai vuri në dukje se edhe pas paralajmërimeve të përsëritura nga Agjencia, TV Gurra vazhdoi me të njëjtën dinamikë të shkeljes së dispozitave ligjore.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit të Agjencisë, mr. Zirjeta Jajaga, kërkoi sqarime nëse radiodifuzeri, edhe pas paralajmërimeve të Agjencisë, vazhdoi të tejkalohte kohën e lejuar për reklama politike të paguara në favor të koalicionit "Vlen" dhe koalicionit të udhëhequr nga BDI. Drejtori Trajçevski konfirmoi se shkelja vazhdoi edhe pas paralajmërimeve të dhëna.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, theksoi se Agjencia dhe Këshilli veprojnë në shkallë të lartë tolerance, duke pasur mirëkuptim për gabimet e mundshme teknike në punën e radiodifuzerëve. Megjithatë, ai theksoi se pas dhënies së paralajmërimit, nëse subjekti nuk vepron në përputhje me dispozitat ligjore, do të pasojnë sanksione përkatëse.

Anëtari i Këshillit Petar Xhurovski bëri një pyetje në lidhje me shumën e gjobës që paguajnë radiodifuzerët në rast të mosrespektimit të Ligjit.

Drejtori, dr. Zoran Trajçevski, shpjegoi se shumta e gjobës përcaktohet nga gjykata, duke marrë parasysh rëndësinë e veprës penale, numrin e të punësuarve të radiodifuzerit dhe të ardhurat e realizuara.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shtoi se në përputhje me Kodin Zgjedhor, për personin juridik është parashikuar gjobë prej 4.000 eurosh në kundërvlerë në denarë, ndërsa për personin përgjegjës të radiodifuzerit është parashikuar gjobë prej 30% të gjobës së shqiptuar për personin juridik. Ajo theksoi se gjykata gjatë përcaktimit të shkallës së dënimit vlerëson të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nën të cilat është kryer shkelja, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer mbi prezantimin mediatik zgjedhor nr.10-4278 /1 datë 7.10.2025 të Shërbimit programor televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Gurra SHPKNJP Kërçovë dhe konstatoi se në kundërshtim me dispozitat e nenit 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor, shërbimi programor i radiodifuzerit, më 30.9.2025, 2.10.2025, 3.10.2025 dhe 4.10.2025, gjatë rrethit të parë të Zgjedhjeve Lokale 2025, në disa orë në kohë reale të programit të transmetuar tejkalo limitet e lejuara për reklama politike të paguara, si më poshtë:

- duke transmetuar reklamim të paguar politik për koalicionin "Vlen", tejkaloi limitin e lejuar prej maksimumi 4 minutash (240 sekonda) për orë reale për dy partitë më të mëdha politike nga pozicioni që në zgjedhjet e fundit për deputet fitoi më shumë vota, dhe
- duke transmetuar reklamim të paguar politik për koalicionin "Aleanca Kombëtare për Integrim" - AKI tejkalo limitin e lejuar prej maksimumi 4 minutash (240 sekonda) për dy partitë më të mëdha politike të opozitës që në zgjedhjet e fundit për deputet fituan më shumë vota.

Në përputhje me nenin 76-v, paragrafi 3 të Kodit Zgjedhor, Këshilli i Agjencisë njëzëri vendosi iniciimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente kundër SHTR TV Gurra SHPKNJP Kërçovë.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente për radiodifuzerin në fjalë.

#### Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtje e harduer sistemit për monitorimin e shërbimeve TV dhe radio të

ORRPKE. Ajo shpjegoi se kemi të bëjmë me furnizim të rregullt publik, parashikuar në Planin Vjetor për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2025. Mjetet për realizimin e furnizimit përmes Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për 2025, dhe mjete shtesë do të sigurohen me Planin Financiar për 2026. Mitrevska informoi se, sipas vlerës së parashikuar të furnizimit, procedura do të realizohet si procedurë e hapur në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizim publik. Procedura do të publikohet përmes Sistemit Elektronik për Furnizim Publik (SEFP), si dhe përmes shpallje në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Ajo shtoi se të gjitha të dhënat relevante dhe detajet shtesë në lidhje me furnizimin janë të përfshira në materialet që u ofrohen anëtarëve të Këshillit.

Z. Sasho Stefanovski pyeti nëse kjo është procedurë e rregullt që realizohet çdo dy vjet dhe nëse Agjencia dhe në periudhën e mëparshme ka realizuar të njëjtën furnizim.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska, u përgjigj se kjo është një procedurë e rregullt me lidhjen e një kontrate për një periudhë dy vjeçare dhe informoi se kontrata aktuale do të skadojë për rreth një muaj, për këtë shkak procedura e re për furnizim publik fillon me kohë.

Anëtari i Këshillit Viktor Pavlovski theksoi se e kuptonte që ky ishte furnizim i rregullt i parashikuar në Planin Vjetor të Agjencisë, por prapë pyeti nëse mund të ketë konflikt me kufizimet ligjore, duke pasur parasysh që vendi është në periudhë zgjedhore.

Udhëheqësja Mitrevska sqaroi se nuk ka asnjë pengesë ligjore për zbatimin e kësaj procedure, pasi bëhet fjalë për furnizim që është parashikuar paraprakisht në Planin vjetor për furnizim publik të Agjencisë. Ajo shtoi se gjatë periudhës zgjedhore nuk lejohet plotësimi i Planit Vjetor me furnizime të reja, por procedurat e rregullta të planifikuara po zbatohen pa probleme, siç ishte edhe në proceset e mëparshme zgjedhore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtje të sistemit harduer për monitorimin e shërbimeve TV dhe radio dhe mbikëqyrjes së ORRPKE.

## **Pika 5**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publi, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: energji elektrike. Ajo shpjegoi se është furnizim publik i rregullt, parashikuar në Planin vjetor për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2025, ndërsa mjetet sigurohen përmes Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025. Mitrevska theksoi se ky tender do të realizohet si furnizim në grup së bashku me Ministrinë e Sportit, pasi të dy institucionet ndodhen në të njëjtën ndërtesë dhe kanë nevoja identike për energji elektrike. Agjencia do të zbatojë procedurën edhe për Ministrinë e Sportit , si pjesë e furnizimit në grup. Procedura do të realizohet si procedurë e hapur, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizim publik, dhe do të fillojë me publikim të njoftimi në Sistemin Elektronik për Furnizim Publik, si dhe me shpallje në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" . Udhëheqësja theksoi se të gjitha të dhënat dhe detajet relevante shtesë në lidhje me furnizimin janë të përfshira në materialet e dorëzuara anëtarëve të Këshillit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: energji elektrike.

**Pika 6**

**Të ndryshme**

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Mr. Sasho Stefanovski**